



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

JANAR-QERSHOR 2016

*Ky raport pasqyron funksionimin e
komunave të Republikës së Kosovës
Këtu janë përfshirë në mënyrë të
përmbledhur aktivitetet e komunave
dhe trupave ndihmese të tyre, për
periudhën janar - qershor 2016*



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

RAPORTI I FUNKSIONIMIT TË
KOMUNAVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
JANAR-QERSHOR 2016

Prishtinë, Korrik 2016

HYRJE

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna. Komunat përmes organeve të veta janë të obliguara të ushtrojnë kompetencat në mënyrë ligjore dhe transparente, duke siguruar edhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale. Ky sistem promovon sjelljen demokratike, transparente dhe llogaridhënien e organeve të komunës si dhe garanton një kontroll të ndërsjellët ndërmjet organeve të komunës. Organet e komunës janë të obliguara që ushtrimin e veprimtarisë së tyre ta zhvillojnë sipas Kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore të organeve qendrore dhe akteve të cilat i nxjerrin vetë.

Në përputhje me përgjegjësitë ligjore dhe mandatin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave, përmes Divizionit të Monitorimit të Komunave, ka mbikëqyrë veprimtarinë e Komunave të Republikës së Kosovës, ku ka hartuar edhe këtë raport gjatë muajit lidhur me funksionimin e komunave. Pikësynim kryesor i këtij procesi ka qenë monitorimi i komunave dhe ofrimi i informatave tek mekanizmat përgjegjës për evitimin e veprimeve komunale të cilat bien ndesh me dispozitat ligjore.

Prezantimi i aktiviteteve të kuvendeve të komunave është mekanizëm i rëndësishëm i vënies së përgjegjësisë së komunave para qytetarëve dhe institucioneve publike. Ky raport përmbledh dhe shtjellon çështjet më të rëndësishme të cilat janë në mandatin e organeve komunale, përkatësisht kuvendit të komunës dhe ekzekutivit. Fokusi kryesor është vënë në pasqyrimin e punës së kuvendeve të komunave, duke ditur se në mënyrë indirekte përfshinë edhe shpalosjen e punës së ekzekutivit, për faktin se ky i fundit i raporton Kuvendit në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga kuvendi i komunës.

QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport ka për qëllim informimin e drejtë të institucioneve qendrore, komunave, qytetarëve, organizatave joqeveritare, dhe çdo grupi tjetër të interesit, për nivelin e funksionimit të komunave karshi mandatit ligjor që kanë.

Përmes këtij raporti mundohemi të krijojmë një pasqyrim të qartë për qytetarët, lidhur me aktivitetet e të zgjedhurve të tyre lokal. Gjithashtu, raporti shërben si një mjet adekuat për të rritur transparencën e organeve të pushtetit lokal.

Në këtë raport janë përfshirë të dhënat e përgjithshme të punëve dhe aktiviteteve të organeve të komunave, për periudhën janar-qershor 2016. Po ashtu, janë përfshirë gjetjet më të rëndësishme të evidentuara gjatë kësaj periudhe.

Në kuadër të raportit, janë përfshirë të dhënat për 38 komuna të Republikës së Kosovës. Vlerësojmë se informacionet e ofruara në këtë raport, e në veçanti gjetjet e paraqitura, do të shërbejnë në të mirë të proceseve të vetëqeverisjes lokale, të rrisin përgjegjësinë institucionale dhe komunat të ndërmarrin hapa konkret në përmirësimin e veprimeve kundërligjore.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Funksionimi i Kuvendeve të Komunave, Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës i komunës, i cili funksionon në bazë të kornizës ligjore për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Kuvendi i Komunës, duhet të mbaj së paku 10 mbledhjeve në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit. Ky është kriteri minimal i specifikuar, i cili kërkohet të respektohet, ndërsa komunave u është lënë mundësia të përshtatin numrin e mbledhjeve varësisht nga nevojat.

Gjatë periudhës janar – qershor 2016, në Republikën e Kosovës kanë funksionuar Kuvendet e 38 komunave. Mbledhjet janë mbajtur rregullisht dhe sipas raporteve të monitorimit, mbledhjet e kuvendeve të komunave kanë qenë të hapura për publikun, me përjashtim të një mbledhje të kuvendit të komunës së Deçanit e cila është mbajtur pa publik. Më qëllim të mbikëqyrjes së punës së kuvendeve të komunave, monitorimi është bërë përmes sistemit të teleprezencës, kurse me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në komunat Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok. Sa i përket mbarëvajtjes së mbledhjeve të kuvendeve dhe funksionimit të punës së tyre, komunat në masën më të madhe kanë respektuar ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës.

Gjatë kësaj periudhe, kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës kanë mbajtur 261 mbledhje. Prej tyre 213 kanë qenë të rregullta, 34 kanë qenë jashtëzakonshme, 12 kanë qenë solemne dhe 2 urgjente.

Mbledhjet e Kuvendeve të Komunës:

- *Mbledhjet e rregullta, 213;*
- *Mbledhjet e jashtëzakonshme, 34;*
- *Mbledhjet solemne, 12;*
- *Mbledhje urgjente, 2.*

Komitetet e Përhershme, Komitetet Tjera dhe Komitetet Konsultative, Sipas LVL-së, kuvendet e komunave themelojnë komitetet e përhershme për të mbështetur punën e tyre. Komunat janë të obliguara të themelojnë Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitetet si komitete të përhershme.

Si mundësi për të ndihmuar organet e komunës në ushtrimin e kompetencave në një fushë të caktuar, Kuvendi i Komunës mund të themeloj komitete të tjera profesionale të cilat do të ndihmojnë atë dhe ekzekutivin në punën e tyre. Këto komitete të veçanta mund të themelohen për sektor specifik si arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj.

Kuvendi i Komunës themelon edhe komitetet konsultative brenda sektorëve me qëllim që të bëjë të mundur pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

Sa u përket Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, ato kanë qenë funksionale në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Sipas të dhënave në komuna janë mbajtur gjithsej 220 mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe 180 mbledhje të Komitetit për Komunitete (KK).

Mbledhjet e Komiteteve të Përhershme:

- **Komiteti për Politikë dhe Financa-220;**
- **Komiteti për Komunitete 180.**

Takimet Publike me Qytetarët, Në nivelin lokal, mekanizmi i pjesëmarrjes së qytetarëve në bërjen e politikave është kriter bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë të cilin duhet respektuar njësitë e vetëqeverisjes lokale. Komunat janë të obliguara të vënë në funksion këto parime përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër përmes së cilës transparenca të ndikoj në avancimin e vetëqeverisjes lokale.

Organizimi i takimeve publike me qytetarë varion nga njëra komunë në tjetrën. Disa komuna i kanë kushtuar më tepër rëndësi organizimit të takimeve publike me qytetarë. Gjatë kësaj periudhe në komunat e Republikës së Kosovës janë mbajtur gjithsej 32 takime publike me qytetarët në 26 komuna. Gjatë kësaj periudhe 12 komuna nuk kanë mbajtur takim publike me qytetarët, si: Fushë Kosovë, Kaçanik, Junik, Istog, Skenderaj, Mamushë, Obiliq, Deçan, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan dhe Zubin Potok.

Raportimi i Kryetarit të Komunës, Ligji për vetëqeverisje lokale ka përcaktuar përgjegjësinë e Kryetarit të Komunës për të raportuar në baza të rregullta ose atëherë kur kërkohet nga Kuvendi i Komunës. Mirëpo, ky ligj nuk ka qartësuar nëse raportet e prezantuara do t'i nënshtrohen një procesi të votimit, si dhe pasojat e mosmiratimit të tyre. Në praktikë është parë se kryetarët e komunave paraqesin me shkrim raportet në kuvendet e komunave, miratimi i të cilave është çështje e brendshme e komunave dhe pa pasoja juridike.

Forma të tjera të raportimit janë ato verbale, ku anëtarët e kuvendit parashtron pyetje të drejtpërdrejta apo me shkrim, varësisht nga natyra e çështjes. Praktika të tilla, janë parë si mundësi e mirë e llogaridhënies së ekzekutivit para kuvendit të komunës dhe ofrimit të përgjigjeve për shumë çështje. Lidhur me obligimin e kryetarëve të komunave për të paraqitur raport para anëtarëve të Kuvendit të Komunës për gjendjen ekonomiko-financiare gjatë kësaj periudhe ka pasur raportime në 38 komuna.

Aktet e Kuvendeve të Komunave, Kompetencë dhe funksion themelor i Kuvendit të Komunës, ndër të tjera është miratimi dhe nxjerrja e vendimeve, rregulloreve për zbatimin e ligjeve që prekin kompetencat e komunave. Po ashtu kuvendi miraton Statutin dhe Rregulloren e punës së Kuvendit, merr vendime si dhe nxjerr rregullore

Aktet e Kuvendeve të Komunës:

- Rregullore - 67;
- Vendime - 991.

dhe aktet tjera të përgjithshme, miraton buxhetin, themelon komitetet e duhura, si dhe shumë akte të nevojshme për funksionimin efikas të komunës. Gjatë kësaj periudhe kuvendet e komunave kanë miratuar, 67 rregullore dhe 991 vendime. Nga gjithsej 1058 akte të miratuara nga kuvendet e komunave, 484 akte janë konfirmuar të ligjshme nga MAPL, 19 të kundërligjshme, ndërsa 555 akte janë dërguar në Ministrinë e linjës për shqyrtim të

ligjshmërisë.

Publikimi i akteve, Një nga përgjegjësitë dhe sfidat kryesore të komunave është funksionalizimi i faqeve të komunave dhe publikimi i akteve. Pasi komunat kanë aktivitete të ndryshme, është paraparë që futja e të dhënave në faqet komunale të jetë e domosdoshme, ngase ju mundëson qytetarëve të jenë më të informuar lidhur me rrethanat dhe gjendjen aktuale të komunës. Detyra për publikimin e akteve komunale është çështje e normuar me Rregulloren Nr.01-2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunave. Pra, sipas kësaj Rregulloreje publikimi i të gjitha akteve nënligjore të komunës është i obligueshëm. Gjatë kësaj periudhe, nga 1058 akte gjithsej sa kanë miratuar kuvendet e komunave 982 janë të publikuara në web-faqet zyrtare të komunave.

FUNKSIONIMI I KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Mbledhjet e kuvendeve të komunave

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë vendimmarrës i komunës, i cili ushtron funksionin e tij në përputhje me legjislacionin për vetëqeverisje lokale. Kuvendi mbledhet rregullisht në mënyrë që të kryej funksionet në kuadër të fushë veprimtarisë së tij, për të miratuar aktet nënligjore të nevojshme për komunën, të cilat kërkohen shprehimisht me legjislacionin në fuqi.


Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar rregullat e mbajtjes së takimeve të Kuvendit të Komunës, në mënyrë që të siguroj njëtrajtshmëri të punës së këtij organi. Ky ligj ka normuar mbajtjen e së paku 10 mbledhjeve në vit të Kuvendit të Komunës, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit.¹ Në këtë periudhë, kuvendet e komunave kanë mbajtur 261 mbledhje. Prej tyre 213 kanë qenë të rregullta, 34 kanë qenë jashtëzakonshme, 12 solemne dhe 2 urgjente.

Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave:

- Mbledhjet e Rregullta 213;
- Mbledhjet e Jashtëzakonshme 34;
- Mbledhje Solemne 12;
- Mbledhjet Urgjente 2.

Në vijim kemi paraqitur grafikun me numrin e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme në kuvendet e komunave:

Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave



Grafikoni 1: Mbledhjet e Kuvendeve të Komunave.

Siç shihet të gjitha komunat kanë përmbushur obligimin ligjor për mbajtjen e së paku 5 mbledhjeve në gjashtë muajorin e parë të vitit, ashtu siç e përcakton Ligji për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht neni 43.2.

Gjatë kësaj periudhe çështjet që kanë dominuar në punën e kuvendeve të komunave kanë pasur të bëjnë me: miratimin e planit të punës së kuvendeve të komunave, shqyrtimi i kornizës afatmesme buxhetore komunale, rishikimi i buxhetit, planet e ndryshme rregulluese urbane, dhënia e pronave të paluajtshme të komunave në shfrytëzim etj.

¹ Ligji Nr.03 L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 43.2.

Mbarëvajtja e mbledhjeve gjatë kësaj periudhe ka qene konform dispozitave të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Mbledhjet kanë qene të hapura dhe transparente, përveç një mbledhje e Kuvendit te Komunës së Deçanit e cila është mbajtur pa publikun. Informimi i qytetarëve në vazhdimësi është bërë përmes faqes zyrtare të komunës shpalljeve të vendosura në objektet e komunave, televizioneve lokale dhe forma të tjera të informimit publik. Komunitat kanë dërguar më kohë ftesën dhe materialet për mbledhje, përveç komunës së Junikut dhe Dragashit, te cilat në disa raste për shkak të problemeve teknike nuk kanë pasur mundësi me i dërgua me kohë materialet për mbledhje.

Lidhur me njoftimin për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe raportuese, përveç komunës së Junikut, Mamushës dhe Dragashit të cilat në disa raste për shkak të problemeve teknike nuk ka pasur mundësi me i dërgua me kohë materialet për mbledhje të gjitha komunitat tjera e kanë kryer këtë obligim ligjor në raport me MAPL-në. Megjithatë, disa komuna kanë dështuar që së bashku me ftesën për mbledhje të dërgojnë në organin mbikëqyrës edhe materialet përcjellëse, siç është përcaktuar me nenin 43.3, të Ligjit për Vetëqeverisje lokale, si komunitat: Partesh, Mitrovicë Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviqi.


Duke ditur se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) është organ mbikëqyrës i komunave, për ato kompetenca të komunave për të cilat me ligji nuk i'u ka dhënë detyrimin ligjor për mbikëqyrje një ministrie sektoriale, është hartuar dhe është realizuar plani gjithëpërfshirës i monitorimit të komunave. Monitorimi i komunave në këtë segment është realizuar përmes metodës së vërejturit me pjesëmarrje, ku kemi pasur qasje në dokumentet zyrtare relevante për qëllimin e monitorimit. Ndërsa, si pjesë kryesore e metodologjisë së përcaktuar kanë qenë edhe takimet me Nënkryetar të Komunave, Kryesues të Kuvendeve të Komunave, Drejtorët e drejtorive të komunave dhe kontaktet me zyrtarët përkatës komunal, ku përmes bashkëbisedimit rreth problemeve është synuar të realizohet një hulumtim kualitativ i ngecjeve dhe të arriturave të komunave nga aspekti i zbatimit të legjisllacionit në fuqi.

Ky planë i cili ka pasur për qëllim që organet e komunave të monitorohen në raport me përmbushjen e obligimeve ligjore, ka paraparë 5 objektiva:

1. Monitorimi i funksionimit të organeve të komunës në zbatimit të legjisllacionit - rishqyrtimi i akteve të kundërligjshme;
2. Menaxhimi i pronës komunale;
3. Transparenca komunale;
4. Integritet Evropiane - Bashkëpunimi Ndërkomunal dhe Komunal Ndërkombëtar;
5. Të drejtat e njeriut.

KOMITETET E PËRHERSHME

Sipas LVL-së, kuvendet e komunave themelojnë komitetet e përhershme për të mbështetur punën e tyre. Komunat janë të obliguara të themelojnë Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitetet si komitete të përhershme. Si rregull, mbledhjet e komiteve mbahen para mbledhjeve të kuvendeve, duke marrë parasysh përgjegjësitë e dhëna me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Megjithatë, vërejmë se komitetet për komunitete në këtë gjashtëmuor janë treguar më pak aktive në krahasim me mbledhjet e kuvendeve të komunave. Numri i takimeve të komiteve të obligueshme është paraqitur si në vijim:



Grafikoni 2: Mbledhjet e Komiteve të Përhershme.

Në total, Komitetet për Politikë dhe Financa në komuna kanë mbajtur 220 takime, kurse Komitetet për Komunitete 180 takime. Krahasuar aktivitetin e tyre, shihet se komiteti për komunitete ka mbajtur 40 takime më pak se sa Komiteti për politikë dhe financa.

KOMITETET TJERA

Si mundësi për të ndihmuar organet e komunës në ushtrimin e kompetencave në një fushë të caktuar, Kuvendi i Komunës mund të themeloj komitete të tjera të cilat do të ndihmojnë atë dhe ekzekutivin në punën e tyre. Këto komitete të veçanta mund të themelohen për sektor specifik si arsimi, shëndetësia, zhvillimi ekonomik, shërbimet publike etj.

Në vijim në formë grafike kemi paraqitur numrin e komiteteve të tjera në komuna:

Komunat	Shëndetësi dhe mirëqenie sociale	Arsim Kulturë rini dhe Sport	Planifikim Hapësinor	Bujqësi	Zhvillim Ekonomik	Urbanizëm	Shërbime Publike	Pronë	Persona me Nevoja të Veçanta	Kategoritë e Dala nga Lufta	Bashkëpunim Ndërkufitar	Barazi Gjinore
Deçan		1				1						
Prizren		1	1			1	1					1
Fushë Kosovë	1	1		1	1	1	1		1			
Gjilan	1	1	1		1		1	1			1	1
Kaçanik							1					
Mitrovicë Jugore	1	1			1	1	1					1
Ferizaj	1	1			1	1			1	1		
Glllogoc	1	1			1							1
Junik							1					
Prishtinë	1	1	1		1		1					
Skenderaj	1	1			1							
Podujevë	1	1	1		1							
Total	7	9	4	1	7	5	7	1	2	1	1	3

Tabela 1: Komitetet e tjera.

Siç shohim nga grafiku dhe tabela më sipërme, në komuna janë themeluar gjithsej 52 komitete të tjera në fushat e paraqitura si më lartë. Prej tyre më së shumti i është kushtuar rëndësi Komitetit për Shëndetësi, Arsim dhe në fushën e urbanizmit.

Megjithatë, në pak raste është vërejtur se këto komitete shqyrtojnë politika të natyrës për të cilën janë themeluar, ngase rolin kryesor e kryejnë komitetet e përhershme. Pengesë është parë edhe mungesa e kompensimit të punës së këtyre komiteteve që ka ndikuar në uljen e ritmit të punës së tyre.

KOMITETET KONSULTATIVE

Kuvendi i komunës në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 73, dhe Udhëzimin Administrativ Nr.2008/10 për Organizimin dhe Funkcionimin e Komiteteve Konsultative në Komuna, është i obliguar të themelojë edhe Komitetet Konsultative më qëllim të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.. Edhe pse themelimi i tyre është i obligueshëm, numri i komunave të cilat kanë themeluar këto komitete është i vogël. Nga gjithsejtë 38 komuna vetëm 10 komuna kanë themeluar këto komitete. Më poshtë gjeni të bashkangjitur tabelën ku janë të evidentuara komunat të cilat kanë themeluar komitetet konsultative për fushat përkatëse:

<i>Komunat</i>	<i>Planifikim Hapësinor</i>	<i>Arsim</i>	<i>Zhvillim Ekonomik</i>	<i>Urbanizëm</i>	<i>Shëndetësi, Mirëqenie sociale</i>	<i>Shërbime Publike</i>	<i>Persona me aftësi të kufizuara</i>	<i>Çështje emergjente</i>	<i>Kulturë, Rini, Sport</i>	<i>Administratë</i>	<i>Të drejta të njeriut, barazi gjinore</i>
<i>Lipjan</i>											
<i>Kamenicë</i>		1	1			1		1	1		
<i>Hani i Elezit</i>			1					1	1		
<i>Ferizaj</i>			1	1					1	1	
<i>Mitrovicë Jugore</i>	1				1	1	1		1		
<i>Shtime</i>											
<i>Gjilan</i>	1										
<i>Gllogoc</i>		1	1		1						1
<i>Vushtrri</i>	1	1		1		1			1		
Total	3	3	4	2	2	3	1	2	5	1	1

Tabela 1: Komitetet konsultative.

Siç vërejmë nga figura e mësipërme, janë themeluar gjithsej 27 komitete konsultative. Në fushën e planifikimit hapësinor (Mitrovicë Jugore, Gjilan, Vushtrri); në fushën e arsimit (Kamenicë, Hani i Elezit, Ferizaj, Gllogoc); në fushën zhvillimit ekonomik (Kamenicë, Hani i Elezit, Ferizaj, Gllogoc); në fushën e urbanizmit (Ferizaj, Vushtrri); në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale (Mitrovicë Jugore, Gllogoc); në fushën e shërbimeve publike (Kamenicë, Mitrovicë Jugore, Vushtrri); në fushën personat me aftësi të kufizuara (Mitrovicë Jugore); në fushën çështjet emergjente (Kamenicë, Hani i Elezit); në fushë e kulturës rini dhe sport (Kamenicë, Hani i Elezit, Ferizaj, Mitrovicë Jugore); në fushën e administratës (Ferizaj); në fushën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore (Gllogocit).

TAKIMET PUBLIKE MË QYTETARËT

Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje është parim bazë i demokracisë së drejtpërdrejtë. Komunat janë të obliguara të vënë në funksion këtë parim përmes formave të ndryshme të komunikimit me qytetarë, takimeve të drejtpërdrejta, informimit publik dhe çfarëdo metode tjetër me të cilën transparenca do të ndikoj në avancimin e vetëqeverisjes lokale. Organizimi i takimeve publike me qytetarë dallon nga njëra komunë në tjetrën. Disa komuna i kanë kushtuar më tepër rëndësi organizimit të takimeve publike me qytetarë, e disa të tjera kanë qenë të rezervuara në këtë drejtim.

Të dhënat e në vijim tregojnë numrin e takimeve të organizuara me qytetarë për periudhën raportuese janar-qershor 2016:




Grafikoni 3: Takimet publike me qytetarët.

Siç shihet nga figura e mësipërme, shumica e komunave kanë përmbushur këtë obligim ligjor lidhur me mbajtjen e takimeve publike me qytetarët. Ndërsa komunat të cilat nuk kanë mbajtur asnjë takim publik me qytetarë për këtë periudhë raportuese janë si vijon: Fushë Kosovë, Kaçanik, Junik, Istog, Mamushë, Skenderaj, Obiliq, Deçan, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zveçan, dhe Zubin Potok.

RAPORTIMI I KRYETARIT TË KOMUNËS PËR SITUATËN EKONOMIKO-FINANCIARE

Në mesin e përgjegjësive të Kryetarit të Komunës është edhe raportimi para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese. Kjo detyrë duhet të përmbushet së paku një herë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës (neni 58, pika j e LVL-së). Raportimi i kryetarit është formë e bashkëpunimit me kuvendin e komunës dhe mundëson funksionimin komplementar të dy organeve. Nga të dhënat e mbledhura për numrin e raportimeve të kryetarëve në kuvendet e komunave, më hollësisht kemi paraqitur përmes grafikomit si vijon:

Numri i raportimeve të Kryetarëve të Komunave lidhur me situatën ekonomiko-financiare.




Grafikoni 4: Raportimi i kryetarëve të komunave.

Nga figura e mësipërme shihet se në të gjitha komunat është përmbushur obligimi ligjor për raportim në kuvendin e komunës së paku një herë në gjashtë muaj ashtu siç është e përcaktuar në nenin 58 pika j) e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

AKTET E KUVENDEVE TË KOMUNAVE DHE PUBLIKIMI

Kompetencë dhe funksion themelor i Kuvendit të Komunës është miratimi (nxjerrja) e rregulloreve dhe vendimeve për zbatimin e ligjeve që prekin kompetencat e komunave. Kuvendi i Komunës është organi me i lart në komunë dhe si i tillë miraton Statutin e Komunës, Rregullore si dhe vendime të cilat kontribuojnë në interes të qytetarëve. Kuvendet e Komunave të Republikës së Kosovës kanë qenë aktive në nxjerrjen e akteve juridike për periudhën raportuese janar-qershor 2016. Ato kanë miratuar akte nga fusha të ndryshme si financiare, planifikimi hapësinor, dhënia në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës. Për periudhën raportuese janë miratuar gjithsej 1058 (njëmijepesëdhjetetë) akte, 67 (gjashtëdhjeteshtatë) prej tyre janë rregullore dhe 991 (Nëntëqindnëntëdhjetenjë) vendime. Në vijimi janë pasqyruar aktet e miratuar për secilën komunë si vijon:

Aktet e Kuvendeve të Komunave



Grafikoni 5: Aktet e kuvendeve të komunave.


Pasqyra e të dhënave numerike për aktet e miratuara tregon se numrin më të madh të Rregulloreve e ka miratuar Kuvendi i Komunës së Kamenicës, derisa numrin më të madh të vendimeve Kuvendi i Komunës së Malishevës dhe Shtimes me nga 46 vendime të miratuara. Në kuvendet e komunave janë miratuar akte të ndryshme në kuadër të fushëveprimit të kompetencave komunale. Numri më i madh i vendimeve ka qenë lidhur me dhënin në shfrytëzim të pronës së komunës, vendime për alokim të mjeteve financiare, vendim për rishikimin e buxhetit, vendim themelimit komiteteve dhe trupave tjerë ndihmës të kuvendit.

PUBLIKIMI I AKTEVE TË KUVENDEVE TË KOMUNAVE

Funksionimi dhe përdorimi i faqeve zyrtare të komunave rregullohet me Udhëzimin Administrativ Nr.03/2011 për web-faqet e Institucioneve Publike. Komunitat janë përgjegjëse që në mes tjerash të respektojnë parimin e transparencës, të krijojnë lehtësira për qasje të publikut në informacionet dhe ngjarjet e komunave, si dhe të krijojnë mundësinë për qasje më të lehtë në dokumentet zyrtare të komunës. Si mjet kryesor për të ofruar qasjen e publikut në këto të dhëna, janë faqet zyrtare elektronike të komunave.

Marrë parasysh se komunitat kanë aktivitete të ndryshme përbrenda institucioneve të tyre, është domosdoshme që futja e të dhënave në ueb faqet komunale, ngase qytetarëve i'u mundëson të jenë më të informuar lidhur me rrethanat dhe ecjet e komunës. Aktualisht, ueb-faqet zyrtare të komunave janë të programuara në gjuhët zyrtare, kështu që përmbajtjet duhet të lansohen në harmoni me rregullat e ligjit për përdorimin e gjuhëve. Kësisoj, ueb-faqet më tepër kanë qenë të azhurnuara me informacione që mbulonin aktivitetet e kryetarëve të komunave dhe performancën komunale.

Të dhënat e komunave lidhur me publikimin e akteve në ëeb faqen zyrtare të komunës janë si vijon:



Grafikoni 6: Publikimi i akteve të kuvendeve të komunave.

Për periudhën raportues Janar-Qershor 2016, 982 (nëntëqindetëdhjetedy) akte të 38 (tridhjetetë) komunave të Republikës së Kosovës janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunave. Komuna të cilat pjesërisht i kanë të publikuar akte janë Komuna e Parteshit dhe Mamushës. Në komunitat Leposaviç, Mitrovicë Veriore, Zubi-potok dhe Zveçan nuk janë funksionale ueb faqet zyrtare të komunës për këtë edhe nuk i kanë aktet e publikuara, ndërsa edhe komuna e Suharekës për periudhën raportuese për vitin 2016 nuk ka të publikuar aktet e miratuara nga Kuvendi i Komunës.

Disa komuna kanë zgjedhur publikimin e akteve në momentin e nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit (Glllogocit), ndërsa disa tjera nuk publikojnë aktet (Komuna e Prishtinës) deri në vlerësimin e ligjshmërisë nga MAPL apo Ministrisë së Linjës.

Komunat të cilat kanë respektuar publikimin e akteve në gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë: Komuna e Prishtinës, Skenderajt, Ferizajt, Mitrovicës Jugore, Kaçanikut, Fushë Kosovës, Prizrenit, Graçanicës, Parteshit, Ranillugut, Klllokotit, Novobërdës, Dragashit, Obiliqit, Vitisë, Podujevës, Kamenicës, Gjilanit, Lipjanit, Pejës dhe Istogut, ndërsa komunat që pjesërisht e kanë përmbushur obligim ligjor e publikimit të akteve në gjuhë zyrtare janë: Komuna e Klinës, Vushtrrisë, Rahovecit, Gjakovës dhe Shtërpçës. Komunat të cilat nuk e kanë përmbushur obligimin e publikimit të akteve në gjuhë zyrtare janë: Shtimes, Deçanit, Junikut, Mamushës, Hanit të Elezit, Malishevës, Suharekës dhe Glllogocit.

Arsyet e mos publikimit të akteve ashtu si e përcakton Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve në Republikën e Kosovës sipas zyrtarëve të komunave gjegjëse është mungesa e stafit përkatës (edhe pse në disa komuna disa herë është shpallu konkursi nuk është paraqitur asnjë kandidat), mungesa e buxhetit adekuat për të kontraktuar ndonjë kompani private etj. E veçanta e disa komunave është se publikimin e akteve e bëjnë edhe në gjuhë zyrtare në komunë (Prizreni) si dhe komuna e Prishtinës në Anglisht në mënyrë që opinioni të jetë me informuar.

SHQYRTIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË KOMUNAVE

MAPL është autoriteti mbikëqyrës i ligjshmërisë së akteve të komunave, nëse përgjegjësia për mbikëqyrjen e tyre nuk i është dhënë me ligj ndonjë ministrie përgjegjëse apo institucioni që ka të bëjë me lëmi të posaçme. Ndërsa, shqyrtimi i kompetencave të deleguara ushtrohet nga organi i qeverisë qendrore që i ka deleguar. Me qëllim të lehtësimit të mbikëqyrjes dhe krijimit të një sistemi më efikas në këtë drejtim, për të realizuar shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve komunale është miratuar Rregullorja (QRK) NR-01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe me këtë është shfuqizuar vendimi nr. 2/119 e qeveris i datës 7 Prill 2010.

Gjatë kësaj periudhe, komunikimi mes komunave dhe organit mbikëqyrës, përkatësisht Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ka qenë i rregullt, dërgimi i akteve të kuvendit të komunës ka qenë i rregullt dhe në afatin e përcaktuar ligjor. MAPL-ja ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë se 503 akteve, ndërsa në ministri e linjës ka dërguar 555 akte të komunave për vlerësim të ligjshmërisë.

SHKELJET LIGJORE NË KOMUNA

Gjatë monitorimit të komunave për periudhën Janar- Qershor 2016, si dhe vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale janë konstatuar 19 shkelje ligjore në 12 komuna. Pas kërkesës së MAPL-së për rishqyrtim të akteve, komunat i kanë harmonizuar 8 akte konform kërkesës për harmonizim, 11 shkelje ende nuk janë harmonizuar në përputhje me kërkesën e organit mbikëqyrës.

Natyra e shkeljeve për të cilat MAPL ka kërkuar nga komunat ti rishqyrtojnë dhe ti harmonizojnë vendimet e kuvendit është: dhënia e pronës komunale në shfrytëzim, e ku shumica nga to kanë bere shkelje te rastet e veçanta për të dhënë në shfrytëzim në rastet e ndarjes së pronës për ndërtim individual të banimit, ndërtimit të objekteve fetare.

Shkeljet ligjore të cilat janë rishqyrtuar dhe janë harmonizuar konform kërkesave të organit mbikëqyrës

Shkelja e konstatuar	Komuna	Vërejtje
Vendimi Nr. 011-6010 për shpalljen e interesit publik me qëllim të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të disa hapësirave shkollore	Gjakovë	E Harmonizuar (25.03.2016)
Vendimi Nr. 06-4062/3 për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Komunës së Dragashit.	Dragash	E Harmonizuar (30.06.2016)
Vendim për dhënien e në shfrytëzim të pronës komunale 10 ari Bashkësisë Islame të Novobërdës për ndërtimin e Xhamisë	Novobërdë	E Harmonizuar (30.06.2016)
Vendimi Nr. 038-88397 për formimin e grupit punues për plotësim-ndryshimin e Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatra, Vendbanime dhe Lagjeve Urbane.	Prishtinë	E Harmonizuar (06.05.2016)
Vendimin komunal Nr.046-88452, për lejimin e afatit shtesë Agjencisë Kosovare të Privatizimit për lirin e hapësirave të cilat i janë dhënë me qira në bazë të kontratës 01Nr. 046-50871/1.	Prishtinë	E Harmonizuar (06.05.2016)
Vendimi Nr. 038-88382 për caktimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës për përzgjedhjen e Këshillave të Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane.	Prishtinë	E Harmonizuar (06.05.2016)
Vendimin Nr. 400-24671 për dhënien në shfrytëzim 99 (nëntëdhjetenëntë) vite ngastrën kadastrale nr.780 në zonën kadastraleTërstenik, për ndërtimin e kishës protestante si dhe lokacionin për varrezat për nevojat e komuniteti Portestant	Glllogoc	E Harmonizuar (10.06.2016)
Vendim Nr.01/11-92214 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.	Prizren	E Harmonizuar (27.07.2016)

Shkeljet ligjore të cilat nuk janë rishqyrtuar konform kërkesave të organit mbikëqyrës

Shkelja e konstatuar	Komuna	Vërejtje
Vendimi Nr.02. datë 28.01.2016, për emërimin e Zëvendës kryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete.	<i>Leposaviq</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi nr.01.5999 për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim me koncesion personave fizik/juridik	<i>Kamenicë</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi Nr.02-035 për miratimin e raportit të komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim	<i>Ranillugë</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi Nr. 2136/16 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë 99 vjet, të pronës së paluajtshme të komunës për nevojat e zgjedhjes së strehimit banesor të familjes së z.Malden Stanojeviq, në parcelën kadastrale nr. P-597/21 ZK Graçanicë, e cila është në pronësi të komunës së Graçanicës.	<i>Graçanicë</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi Nr. 2133/16 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë 99 vjet, të pronës së paluajtshme të komunës për nevojat e zgjedhjes së strehimit banesor të familjes së z.Srbobran Rashiq, në parcelën kadastrale nr. P-485/8 ZK Graçanicë, e cila është në pronësi të komunës së Graçanicës	<i>Graçanicë</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi Nr. 2135/16 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë 99 vjet, të pronës së paluajtshme të komunës për nevojat e zgjedhjes së strehimit banesor të familjes së z.Marko Miljkoviq, në parcelën kadastrale nr. P-1946 ZK Graçanicë, e cila është në pronësi të komunës së Graçanicës.	<i>Graçanicë</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi Nr. 2134/16 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë 99 vjet, të pronës së paluajtshme të komunës për nevojat e zgjedhjes së strehimit banesor të familjes së z.Ivan Miljkoviq, në parcelën kadastrale nr. P-1946 ZK Graçanicë, e cila është në pronësi të komunës së Graçanicës.	<i>Graçanicë</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendim paraprak Nr.011-23746 për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale	<i>Gjakovë</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite për ndërtimin e shtëpisë	<i>Zubin Potok</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi Nr. 01-16-2733 për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë për rastet e veçanta për ndërtimin e shtëpive për strehim	<i>Shtërpçë</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi 01 Nr.06-2734/2016 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 40 vite të pronës komunale, për ndërtimin e shtëpive të banimit për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptas të rikthyer.	<i>Klinë</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>
Vendimi Nr. 400-34429 për dhënien në shfrytëzim 10 (dhjetë) vite aneksin e komunës së vjetër OJQ-së Qëndresë për Promovimin e Drejtave të Grave të Komunës së Glllogocit në mbledhjen e datës 10.06.2016.	<i>Glllogoc</i>	<i>Nuk është rishqyrtuar</i>

Rekomandime:

- Të mbahen takime publike gjithëpërfshirëse me qytetarë në komunat: Deçan, Junik, Mamushë, Skenderaj, Ferizaj, Skenderaj, Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zveçan, Istog, Kaçanik, Fushë Kosovë, Obiliq, (sipas nenit 68.1 të LVL-së);
- Të themelohen komitet konsultative në komunat të cilat nuk kanë përmbushur këtë obligim ligjor konform, Nenit 73 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;
- Aktet e Komunave të hartohen konform Rregullores Nr.01/2013 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave.
- Komuna e Deçanit, Junikut dhe Mamushës, dhe Shtimes të publikojnë aktet e organeve të komunave në gjuhët zyrtare konform rregullores për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave;
- Me rastin e miratimit të vendimeve për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim të respektohen procedurat ligjore ashtu siç përcakton Ligji Nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale, si dhe Rregulloren QRK Nr. 23/2013 për përcaktimin e procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës
- Komuna e Junikut dhe e Dragashit të dërgojnë me kohë në MAPL, materialet për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendeve të komunave, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale;
- Aktet e organeve të komunave të vlerësuara nga organi mbikëqyrës si të kundërligjshme, të kthehen për rishqyrtim në Kuvendin e Komunës, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të kërkesës;
- Të funksionalizohet sistemi i teleprezencës në të gjitha komunat ku nuk është funksionale.
- Aktet e miratuara nga organet e komunave të publikohen në linkun e përcaktuar për publikim në faqet zyrtare të komunës, konform Rregullore Nr.01/2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave;
- Përcaktimin e afatit të hyrjes në fuqi të akteve të komunës, duhet të bëhet ashtu si e ka përcaktuar nenin 18 i Rregullores së MAPL-së Nr. 01/2013 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunave;
- Të mos jepet prona e paluajtshme komunale në shfrytëzim sipas kërkesave individuale;
- Të bëhet regjistrimi dhe publikimi në ueb-faqen zyrtare të komunës i pronave të paluajtshme e komunës;
- Të bëhet regjistrimi dhe publikimi në ueb-faqen zyrtare të komunës i pronave të paluajtshme e komunës të dhëna në shfrytëzim;
- Të bëhet regjistrimi dhe publikimi në ueb-faqen zyrtare të komunës i pronave të paluajtshme e komunës që janë dedikuar për dhënie në shfrytëzim afatgjatë.